



Pranimi / Dohet Prilaps / Prilaps Received / Dohet	11. 08	2023	3	viti god Year
Organ / Institucija Organ / Institution Org / Inst	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shkronja Prilaps Appendix	Sasia Kopësia Quantity	
KPMShCK	56651	2023 /	115	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.890/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.840/2023 të datës 13.06.2023 dhe ankesën A.nr.890/2023 të datës 29.06.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë:

Vendimit me numër VK/2023 të datës 27.07.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në një ankesë me numër A.nr.890/2023, kundër Vendimit me numër Nr.1-111/01-22192 të datës 02.05.2023 të Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.890/2023 e datës 29.06.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.1-111/01-22192 i datës 02.05.2023 i Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit.

A r s y e t i m .

Komuna e Lipjanit duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 si dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht më datë 16.03.2023 ka njoftuar lidhur me konkursin numër të referencës Nr. RN00011227, ndërsa më datë 06.04.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale lidhur me pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime Sociale 2".

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Kryetari i Komunës së Lipjanit më datë 10.05.2023 ka nxjerr Vendimin me numër Nr.1-020/04-23850

për Formimin e Komisionit për Pranim në Shërbimin Civil, për pozitën për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale- „Zyrtarë për Shërbime Sociale 2”.

Tutje Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Lipjanit më datë 02.05.2023 ka nxjerr Vendimin me numër Nr.1-111/01-22203, sipas të cilit ankuesja është njoftuar se nuk është përfshirë në listën e ngushtë në konkursin për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën e punës “Zyrtar për Shërbime Sociale 2”, me arsyetimin se të njëjës i mungon përvoja e punës prej një (1) vite përvojë pune profesionale.

Kundër Vendimit me numër Nr.1-111/01-22192 të datës 02.05.2023 të Njesisë së Personelit të Komunës së Lipjanit, më datë 05.05.2023 ka parashtruar ankesë në Zyrën e Personelit në Komunën e Lipjanit. Ndërsa më datë 10.05.2023 Udhëheqësja e Personelit përmes përgjigjes në ankesë me numër 01 Nr.111/01-23958 e ka njoftuar ankuesen se ankesa e saj është refuzuar, pasi që e njëjta nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës prej një (1) viti ashtu siç është kërkuar në konkurs.

Më datë 13.06.2023 ankuesja, përmes postës ka parashtruar ankesë e cila është protokolluar me numër 4726/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimin me numër Nr.1-111/01-22203 të datës 02.05.2023 të nxjerrë nga Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Lipjanit. Po ashtu, ankuesja me datën 29.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4951/2023 e cila është regjistruar me numër A.nr.890/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 29.05.2023.

Me qene se te dy ankesat e parashtruara nga ankuesja, kane qene për të njëjtin akt administrativ të nxirr nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, lidhur me te njëjtin objekt të shqyrtimit, gjegjësisht njoftimi i datës 29.05.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, pas vlerësimit te ankesës me numër A.nr.840/2023 si dhe ankesës me numër A.nr.890/2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur me datën 24.07.2023 ka nxjerr Vendimin VK/2023 me numër protokollit 5335/2023 përmes te cilit vendim ankesa e ankueses A.nr.840/2023 te datës 13.06.2023 është bashkuar me ankesën A.nr.890/2023 te datës 29.06.2023, ndërsa lënda tani e tutje do te trajtohet ne tërësi nen shenjen A.nr.890/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.06.2023 dhe 04.07.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë te Komuna e Lipjanit. Ndërsa Këshilli më datë 19.06.2023 dhe 06.07.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me të gjitha shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 4726/2023 të datës 13.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 30.05.2023 për Komisionin e Ankesave dhe Parashtrësive; Konkursin e jashtëm me numër reference Nr.RN00011227 e datës 06.04.2023; Vendimin me numër Nr.01-102/02-19741 të datës 19.04.2023; Ankesën e datës 05.05.2023; Përgjigjen në ankesë me numër 01 Nr.111/01-23958 të datës 10.05.2023; Njoftimin me numër protokollit 1-111/01-27281 të datës 29.05.2023;

Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional për periudhën kohore 16.11.2018 deri më 25.05.2023; Vendim me numër Nr.1-150-56729 i datës 12.10.2016; Vendim me numër Nr.1-113-38198 i datës 13.07.2021; Vërtetimin me numër Nr.546-113/1 të datës 30.12.2016; Vërtetimin me numër Nr.018-113 të datës 08.01.2016; Vërtetimin me numër Nr.546-113 të datës 24.08.2016; Referencën me numër Nr.777-113 të datës 02.03.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.06.2023; Përgjigje në ankesë e 19.06.2023; Lista e aplikantëve me numër reference RN00011227; Vendim me numër Nr.1-020/04-23850 i datës 10.05.2023; Akt Emërimi i [redacted] i datës 22.07.2013; Akt Emërimi me numër [redacted].Nr.1-112-37766/2021 i [redacted] i datës 09.07.2023; Akt Emërimi me numër [redacted] Nr.01-112/01-4622/2023 i [redacted] i datës 20.01.2023; Akt Emërimi i [redacted] i datës 05.11.2013; Kontratë Pune; Vendimin me numër Nr.1-111/01-22192 i datës 02.05.2023; Aplikacionin me numër reference RN00011227 i datës 10.04.2023; Diplomë me numër protokoll 44/495 e datës 27.08.2010; Diplomë e datës 22.07.2016; Certifikatë e datës 06.05.2016; Certifikatë; Certifikatë; Certifikatë; Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021; Kopje e letërnjoftimit; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 21.03.2022; Aplikacion i [redacted] i datës 07.04.2023; Diplomë e datës 01.07.2015; Diplomë e datës 07.10.2019; Certifikatë; Certifikatë e datës 03.12.2018; Certifikatë; Certifikatë tetor 2021; Certifikatë; Certifikatë; Vërtetim i datës 24.05.2018; Vërtetim mbi praktikën i datës 10.06.2019; Vërtetim me numër Nr.3-113-8032 i datës 15.03.2022; Trusti i datës 12.06.2022; Kontratë e vullnetarit e datës 24.04.2021; Shkresë e datës 27.04.2021; Vërtetim i datës 01.11.2022; Referencë e datës 26.09.2022; Letërnjoftim [redacted]; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 06.04.2023; Njoftim me numër protokoll 1-111/01-27281; Vendimin me numër te protokollit 5335/2023 te datës 24.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankueses [redacted] është e pabazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit me numër reference RN00011227 për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale kanë qenë:

- *Diplomë e arsimit të lartë më së paku tre (3) vite të studimeve. Fakulteti i Psikologjisë, Punë Sociale, Sociologjisë dhe Juridik;*
- *Kualifikime të Posaçme formale; si dhe*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, Kolegji pas analizimit të dosjes së aplikimit të ankueses dhe provave të organit të punësimit ka gjetur se ankuesja me rastin e aplikimit për këtë pozitë si dëshmi të kualifikimit shkollor dhe përgatitjes së përvojës së punës posedon: Diplomë Universitare me numër Nr.4683 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës më datë 22.07.2016 me të cilën dëshmohet se ankuesja e ka perfunduar Fakultetin Filozofik drejtimi Pedagogji Sociale me date 06.05.2016 dhe mori titullin "Bachelor i Pedagogjisë Sociale" si dhe me përvojë të punës si ne vijim : sipas Referencës me numër Nr.777-113 të datës 02.03.2022 të lëshuar nga Drejtoresha e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Lipjanit me të cilën dëshmohet se ankuesja ka përfunduar punën praktike dhe profesionale nga data 06.01.2016 deri më date 30.06.2016 dhe nga data 01.07.2016 deri më date 30.09.2016 si dhe prej datës 13.07.2021 deri më 30.11.2021, andaj ne baze te deshmive të ofruara Kolegji ka vërtetuar se

kandidatja [redacted] deri në momentin e përcaktimit të listës së ngushtë ka pasur gjithsejtë njëmbëdhjete (11) muaj përvojë të punës pas diplomimit dhe se e njëjta nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës ashtu siç është kërkuar në konkursin me numër të referencës RN00011227 „ *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ne baze të dëshmimeve të ofruara ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, bazuar në kriteret e konkursit po ashtu edhe dëshmitë e bashkangjitura nga ankuesja, ka bërë vlerësimin paraprak në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht në bazë të kësaj ankuesje me Vendimin me numër Nr.1-111/01-22192 të datës 02.05.2023 është njoftuar se e njëjta nuk i plotëson kriteret e konkursit me arsyetimin se i mungon përvoja profesionale e punës, ngase në konkurs është kërkuar së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësim të pozitës së lirë të punës. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, janë përcaktuar kriteret për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht pozita për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale 2, hyn në kategorinë e nivelit profesional 2, ku shtojca me numër Nr. 1/7 pika IV e kësaj rregulloreje tek kërkesat e përgjithshme formale- përvoja e punës theksohet se: *“Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”,* e në këtë rast meqenëse ankuesja bazuar në dëshmitë të cilat i ka paraqitur me rastin e aplikimit nuk ka arritur të dëshmojë përvojën e punës prej 1(një) viti përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”, ashtu siç është kërkuar me konkurs përveç dëshmisë të lëshuar nga Drejtoresha e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Lipjanit me date 02.03. 2022 me të cilën dëshmohet se ankuesja ka përfunduar punën praktike dhe profesionale dhe e njëjta gjithsejtë ka njëmbëdhjete (11) muaj përvojë të punës pas diplomimit në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës siç kërkohet në konkurs. Po ashtu ankuesja ka dorëzuar edhe Pasqyrën e Trustit Pensional por nuk ka nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi kontrate të punës apo vertetim punesimi nga institucioni përkatës, me të cilat dëshmohet saktë periudha e përvojës së punës, pozita të cilën e ka mbajtur dhe për çfarë periudhe kohore ka punuar në atë pozitë, kohëzgjatja në pozitën e caktuar dhe arsytet e shkëputjes së marrëdhënies së punës nga ajo pozitë, gjë që për Kolegjin ka qenë e pamundur të vërtetoj periudhën kohore të punës së ankueses lidhur me pozitën të cilat i ka mbajtur tek institucioni përkatës dhe periudhën kohore se sa ka punuar sipas dëshmisë së ofruar gjegjësisht Trustit Pensional, andaj sipas normave ligjore e njëjta nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara të konkursit, rrjedhimisht Kolegji konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Lipjanit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.1-111/01-22192 të datës 02.05.2023 për mos përfshirje në listën shkurtër të ankueses ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafi 1, 2, dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak..5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për*

aplikim në pajtim më paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin” ndërlidhur me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe shtojcën me numër Nr. 1/7 pika IV, e të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Andaj mbi këtë mbi këtë bazë pretendimi i ankueses se e njëjta i ka plotësuar kushtet e konkursit për sa i përket përvojës së punës është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, konstaton se Zyra e Personelit të Komunës së Lipjanit Vendimin me numër Nr.1-111/01-22192 të datës 02.05.2023 e ka nxjerrë në përputhje me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 47, 48 dhe 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.890/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.